



Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 14.04.2023, nxjerrë këtë:

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT AGENCIJA ZA SPRJEČAVANJE KORUPCIJE THE AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION	
Dep. Dop. Dop.	06
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	749/23
Nr. Faq. Br. Dtr. Nr. Page.	03
Data Datum Date	14.04.2023

V E N D I M

- Mbyllet rasti me nr. AKK-DPKI-06-4511/22, për zyrtarët e lartë z. Reshat Selimaj dhe Xhevxhet Gashi, Anëtar të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve në Suharekë”, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.**

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarët e lartë z. Reshat Selimaj, Kryetar i Komisionit Komunal të Aksionarëve në NPL “Stacioni i Autobusëve” SH.A., në Suharekë dhe z. Xhevxhet Gashi, anëtar i këtij komisioni, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas pranimit të informatës nga raportuesi i jashtëm, ka filluar trajtimin e këtij rasti me pretendimin për konflikt të interesit në rastin e z. Reshat Selimaj, i cili si kryesues i Komisionit Komunal të Aksionarëve ka marrë pjesë (intervistim, vlerësim dhe vendimmarrje) në procesin e rekrutimit për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit Drejtues të Ndërmarrjes, në të cilin proces rekrutues ka marrë pjesë edhe z. Fatmir Kuqi, i cili është nipi (djali i motrës) i z. Selimaj. Ndërsa, z. Xhevxhet Gashi, si anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve ka marrë pjesë (intervistim, vlerësim dhe vendimmarrje) në procesin e rekrutimit për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit Drejtues të Ndërmarrjes, në të cilin proces rekrutues ka marrë pjesë edhe z. Qëndrim Gashi, i cili është i të njëjtit fshat, të njëjtës lagje por edhe faresti me z. Xhevxhet Gashi. Gjithashtu, raportuesi pretendon se ka pasur shkelje ligjor edhe me rastin intervistimit të kandidatëve të cilët kanë qenë pjesë e ndërmarrjes për 6 vite radhazi (në dy mandate).

Lidhur me këtë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ka njoftuar zyrtarët e lartë lidhur me fillimin e procedurës

për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit (DPKI-06-02/4666/22, DPKI-06-4667/22).

Në prizën e sqarimit të rastit, Agjencia ka mbajtur takim me zyrtarët në fjalë, me ç'rast i ka njoftuar me pretendimet e ngritura lidhur me situatën e mundshme të konfliktit të interesit, si dhe ka dëgjuar sqarimet e zyrtarëve lidhur me pretendimet në fjalë. Në sqarimin e dhënë, z. Reshat Selimaj ka deklaruar se, *“sa i përket procesit të rekrutimit për anëtarë të Bordit Drejtues të Ndërmarrjes, ku një nga kandidatët ishte nipi im, ju njoftoj se lidhur me këtë jam tërhequr nga procesi i vlerësimit dhe votimit për të gjithë kandidatët pjesëmarrës dhe se lidhur me këtë ekziston edhe procesverbali përkatës. Ndërsa sa i përket pretendimeve lidhur me z. Xhevxhet Gashi, i njëjti ka deklaruar se, “nuk kam kurrfarë lidhje familjare me kandidatën Qëndrim Gashi, i cili ka qenë pjesë rekrutimit në këtë proces.”*

Me qëllim të konstatimit të gjendjes faktike, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka kërkuar nga Komuna e Suharekës, dokumentacionin relevant lidhur me procesin e rekrutimit në fjalë (DPKI-06-02/4675/22), e gjithashtu është kërkuar informacion edhe nga Agjencia për Regjistrim Civil sa i përket lidhjes së mundshme familjare ndërmjet z. Xhevxhet Gashi dhe Qëndrim Gashi (DPKI-06-02/4737/22), si dhe ka mbledhur informata nga personat që kanë qenë pjesëmarrës në këtë proces (Nr.Prot.4666-1/22).

Pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant të siguruar nga Komuna e Suharekës, Agjencia e Regjistrimit Civil, si dhe informatave nga personat pjesëmarrës në këtë proces, pastaj dispozitave ligjore përkatëse, Agjencia ka gjetur se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për konflikt të interesit në rastet e sipër trajtuara. Kjo për faktin se:

Sa i përket rastit të parë, për të cilin pretendohet se z. Reshat Selimaj, si kryetar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes, ka marrë pjesë në vendimmarrje me konflikt të interesit në procesin rekrutimit të kandidatëve për anëtar të bordit të ndërmarrjes, Agjencia ka gjetur se, sipas Procesverbalit Nr. 491/22 i datës 10.11.2022, të Komisionit Komunal të Aksionarëve të NPL “Stacioni i Autobusëve” në Suharekë, z. Selimaj është tërhequr nga votimi me rastin e hedhjes së kandidatëve për votim/përzgjedhje, pasi që i njëjti ka vlerësuar se ka konflikt të interesit me njërin nga kandidatët pjesëmarrës në konkurs. Me këtë rast, z. Selimaj ka vepruar konform paragrafit 1 të nenit 17 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Lidhur me pretendimin e raportuesit të rastit se, z. Selimaj ka qenë prezent gjatë gjithë kohës së intervistimit të kandidatëve, pjesë e të cilëve ka qenë edhe nipi i z. Selimaj, Agjencia ka mbledhur informata nga personat pjesëmarrës në procesin e intervistimit dhe atë me qëllim të konstatimit të çasteve paraprake të vendimmarrjes të cilat kanë mund të shpien në konflikt të interesit. Sipas këtyre informatave (Nr.Prot.4666-1/22 – *deklaratat e anëtareve të Komisionit Komunal të Aksionarëve SH.Z. dhe XH.G., si dhe procesmbajtëses/sekretares së ndërmarrjes Q.K.*), z. Selimaj ka deklaruar konfliktin e interesit dhe është tërhequr nga vendimmarrja, ndërsa për kohën sa ka prezantuar ditën e intervistës i njëjti nuk ka parashtruar pyetje ndaj kandidatëve.

Andaj, në bazë të shkresave të lëndës nuk është vërtetuar se z. Selimaj ka marrë pjesë në vendimmarrje në konflikt të interesit ashtu siç përcaktohet me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili vendimmarrjen e përcakton si – *çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik*. Ndërsa prezenca e të njëjtit si anëtar/kryesues i KKA-së në fazën e intervistimit të kandidatëve, duke mos parashtruar pyetje (*sipas deklaratës së z. Selimaj, anëtarëve tjerë të KKA-së dhe procesmbajtëses/sekretares së ndërmarrjes*) përmes të cilave ka mundur të vlerësoj më pakë kandidatët e tjerë dhe kështu të favorizoj nipin e tij, nuk mund të konsiderohet si çast paraprak, thelbësor dhe përcaktues për përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës.

Sa i përket pretendimit të dytë, lidhur me atë se z. Xhevxhet Gashi, si anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve ka marrë pjesë vendimmarrje me konflikt interesi në procesin e rekrutimit për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit Drejtues të Ndërmarrjes, në të cilin proces rekrutues ka marrë pjesë edhe z. Qëndrim Gashi, i cili është i të njëjtit fshat, të njëjtës lagje por edhe farefisi me z. Xhevxhet Gashi, Agjencia përmes shkresës (Nr.02/1741) ka pranuar informacionin nga Agjencia e Regjistrimit Civil, sipas të cilës nuk është konstatuar ndonjë lidhje familjare ndërmjet z. Xhevxhet Gashi dhe z. Qëndrim Gashi.


Lidhur me pretendimin e raportuesit të rastit, se shkelje ligjor ka pasur edhe me rastin intervistimit të kandidatëve të cilët kanë qenë pjesë e ndërmarrjes për 6 vite radhazi (në dy mandate), Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit nuk është kompetente dhe nuk lëshohet në interpretim sa i përket pretendimit në fjalë.

Rasti në fjalë është trajtuar vetëm në kontekst të kufizimeve, ndalesave dhe përkufizimeve të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit (si çështje administrative), dhe nuk është trajtuar nga aspekti penal (konsumimi i veprës penale) sipas Kodit penal të Republikës së Kosovës.

Andaj, nga sa u tha më lartë, në rastin konkret nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Ylli Buleshakaj
Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit